

DIBENI FLORA

8541

LIP

**Natasha Lako**  
**NATYRE E QETE**  
**POEZI**



81H-1  
          
LIP

Natasha  
Lako

Redaktor  
SHVITIM ARBANA

Piktur  
BESHIK TRUNGU

# Natyrë e qetë



POEZI

SHTËPIA BOTUESE

«NAIM FRASHËRI»



## E VËRTETA (IME)

Po të mos ishte pisha me gjelbërim të përjet-  
shëm që nxjerr rrëshirën  
si lot të pastër fëmije dhe plaku,  
po të mos e mblidhte përditë në një kovë të  
vjetër  
një njeri i thjeshtë që të gjithë ia kuptojnë  
ëndrrën e vet,  
po të mos kthehej ky lot në goma makine  
që lëvizin gjithmonë,  
s'do të isha poete.

Po të mos ishte zogu që fluturon në hapësirë  
e të mos ulej pastaj në një fije bari,  
po të mos e kosiste atë bar, ku asgjë s'do të  
çlodhej më kurrë!  
një vajzë që pret të fluturojë në një ëndërr  
tjetër njeriu,  
po të mos binte të hapej ëndrra e saj tek unë,  
s'do të shkruaja.

Po të mos ishte një njeri që kërkon gjithmonë  
gjysmerrësirë,  
që askush mos t'ia deshifrojë sytë, zemrën,  
veshjen, qeshjen porsì unë  
e kot pret që ëndrra e tij të mbijë,  
po të mos kisha lindur në vend të dëshirave  
të tij unë,  
s'do të isha kaq e mirë.



## UNË

Pak filozofi,  
pak dashuri,  
kafe me pak,  
pak vonesë në park.

Ose tepër filozofi,  
ose tepër dashuri,  
ose sheqer më tepër në kafën me pak,  
më tepër (do të thotë) të humbasësh në  
park.

Më mirë pak filozofi,  
më mirë pak dashuri,  
më mirë kafe me pak,  
dhe pak vonesë, (ngaqë s'mund të  
humbasësh) në park.

Më mirë një gënjeshtër më pak.

Gruaja

## E P A R A

*Të gjitha... e para i ndjeu gruaja,  
Gruaja harmonikja, shenjë e gjithësisë,*

*Çorapet që grisen dhe që duhen paguar,  
Të gjitha...*

*dhe fikjen e dashurisë*

*Të gjitha... e para i ndjeu gruaja.  
Si njeri shpendëror, brenda çdo çasti solemn,*

*Kur toka në thellësi rënkon.  
Çdo shpend ngrihet në qiell.*

1987

*shogorave*

## VATHËT E RINJ

*As flori, as të larë me argjend,  
po prej bririt të drrerit vrarë  
në gjueti të ndaluar.*

*Gjahtarit i bënë procesverbal,  
i morën çiftin, ia varën në klubin e  
gjuetisë.*

*Merceologët u ulën të caktojnë çmimin  
e bririt copë-copë.*

*Ti qesh dhe vathët dridhen, kur kalon  
në pyllin e dashurisë.*

1987



✓  
PRITJA

✕ Jam ulur në një qoshe të dashurisë  
ku bie shi papushim. ✕

Asnjëherë nuk të thashë, i dashur,  
asnjëherë nuk të thashë, të dua.

Jam ulur në një qoshe të dashurisë  
dhe të pres.

## KOHA JONË HOMERIKE

Koha jonë homerike  
prish njëra pas tjetrës gjithë fjalët e  
panevojshme,  
fjalët e krimbura nga pas' mbin fruti prej  
farës.

Vjen gjithnjë koha e Homerit,  
mbin fati i tij i madh.

Koha jonë homerike  
prish njëra pas tjetrës studiot e poetëve,  
makinat e shkrimit, sekretaritë, surin magjik.  
Vjen gjithnjë koha e Homerit,  
mbin syri i tij i gjallë.

Koha jonë homerike  
poetët i kthen në endacakë të jetës,  
për të treguar ato që nuk harrohen kurrë  
se njeriu ka nevojë ta takojë njeriun përballë.  
Lind gjithnjë koha e Homerit,  
mbin pastaj fjala.

1989

23  $\frac{74}{11}$

39 16

39  
 $\frac{16}{23}$

9

*shkëlqim*

## NË NJË AEROPORT TË PAEMËR

*Kemi hyrë në vorbullën e Evropës,  
ne të dyja nga rruga «Perlat Rexhepi».*

*Kemi hyrë në vorbullën e Evropës,  
Perlat Rexhepi u vra në Shkodër.*

*Kemi hyrë në vorbullën e Evropës,  
ne të dyja nga Korça jemi.*

*Kemi hyrë në vorbullën e Evropës,  
para nesh Korça ka hyrë  
e para Korçë, ndoshta Shkodra.*

*Ato të dyja aëndrojnë në brequn e tyre,  
Perlat Rexhepi i vrarë doli të rrijë,  
në rrugicën më të bukur të botës.*

*Prej rrugicës më të bukur të botës jemi nisur,  
kemi hyrë në vorbullën e Evropës.*

**1987**



24

**KTHESA E RRUGËS SIME  
TË GJELBËR**

*Kthesa e rrugës sime të gjelbër  
i ngjan shiritit të një elektrokardiogrami:  
Kur kthehem për diku,  
jetoj.*

*Gruoja*

## SHQIPTARKA

*Shamia nga koka të ra,  
e bardhë si një re,  
nuk ka më Delakrua,  
nuk ka Koro, Mone.*

*Çelës në brez nuk ka,  
ka magje në muze  
s'vjen dot më Delakrua,  
s'vjen dot Koro, Mone.*

*Peneli më s'të gjen,  
një botë tjetër soj.  
Shqiptarkë, në su çfarë fsheh,  
që zemra të dallon?*

PËRDERISA NË JETË KEMI GJITHMONË  
DIÇKA TË PAFILLUAR

Përderisa në jetë kemi gjithmonë diçka të  
pafilluar,  
që nga ky trotuar si kraharor mikpritës i  
vjetër,

deri te kraharori yt burrëror;  
përderisa në jetë kemi gjithmonë diçka të  
pafilluar,

që nga shiu që vrapon si një shkollar i vogël,  
deri te dielli yt si shi;

përderisa në jetë kemi gjithmonë diçka të  
pafilluar,  
që nga vrapimi i lumit dhe hënës drejt  
dashurisë

deri te vrapimi i ne të dyve drejt njëri-tjetrit,  
deri te gjethet që bien për të pirë ne të dy  
pafundësinë ose hapësirën vetë,

përderisa në jetë kemi gjithmonë diçka të  
pafilluar,  
të pafilluar kemi veten.



## **RRI DHE DËGJOJ HAPAT E TU**

*Gjithmonë i ngjas një godine të sapombaruar  
filluar prej qindra vjetësh më parë.  
Rri dhe dëgjoj hapat e tua  
pa e ditur kur ke ardhur.*

*Ndiej se si çel një nga një dritaret,  
se si mbjell lule pastaj;  
kjo do të thotë se në mesin e gjakut  
je bërë banori i saj.*

## LLOGARIA

slap

Gratë këshillohen të llogarisin ditët,  
për të kontrolluar rregullisht gjendrat e  
gjoksit.

Ndërkohë edhe hëna ka numëruar kohën  
e saj enigmatike,  
baticë ka pasur, zbaticë sipas të gjithë  
kalendarëve

Kërçelli i misrave i ngjan një mendimtari të  
vjetër

që llogarit shpërthimin e gjetheve.

Të gjithë mendojnë të jenë aq të përpiktë,  
sa kërkojnë 2mm të rritet përditë bishti i  
fazanëve

Ndërkohë numërohen vazhdimisht edhe  
banknotat e bankës qendrore,  
ndërsa në periferi paret e tyre numërojnë  
hajdutët,

njësoj si ata që llogarisin buzëqeshjet e tyre.

Dhe do të vijë dita që ata bashkë  
të numërojnë me gishta ditët e dënimit.  
Gjakftohtësi kërkohet në llogari, asgjë tjetër.

Vetëm dashuria masën e vet s'e ka gjetur.

## KOHA E LAMTUMIRËS DËT YË

(K.)

Ekranin e bardhë desh përpara,  
nga hynte bota, nga hynte jeta,  
ku ligjet e fizikës mbliidhen  
a ligjet e elektricitetit.

Pastaj kërkoi një dritare,  
ku priste, priste vazhdimisht,  
që harabeli të hapte krahët,  
të shkiste reja qetësisht.

Dhe maste botën, maste jetën,  
me dy tri rreze në dritare,  
sikur s'ishte shpikur elektriciteti  
dhe nuk ishte nxjerrë as metali.

Se kishte mbetur veç njeriu  
dhe dritarja zemërgjerë.  
Dhe shkrihej bota vetvetiu,  
me mall dhe dritë të pathënë.

1986

8 - 97





*dashurisë*

## **TY TË GJETA**

*Ty të gjeta fare thjesht, fare papritur.  
Dhe ti më the thjesht, vendlindjen, emrin  
tënd.*

*Trokita te ti, nuk më the as hyrë, as prit.  
Pa ditur ç'të bëja, vetëm këndova,  
I këndova dashurisë, shpresës, trëndafilit, të  
bukur.*

*Ku ta dija unë se nëpërmjet teje,  
Si një trëndafil i vjetër, i këputur do të hyja,  
të vështroja më pas gjithë botën.*

Grupe

## NGA RETË RRETHUAR

Një peshqir i nderë në ballkon  
jashtë rregullave urbanistike.  
Këllëfë të posaqëndisur,  
çarçafë të ngarkuar me jetë si me shi.

Më sipër,  
re të rënda, që përplasen me njëra-tjetrën.  
Më poshtë  
asfalti i mbushur me ngjarje.

Pastaj  
reja e vogël e zemrës,  
e posaçarë nga dielli.

Qielli s'është aq i madh  
sa t'i mbajë të gjitha në krahë.

Një papuçe e vogël fëmije,  
re e bardhë.

## GJEJE PËRSE KAM ARDHUR

Gjeje përse kam ardhur  
e hipur në vaporin e majit,  
që lëshon trumbetat e tij në hapësirë.

Gjeje përse kam ardhur,  
as si mik, as si udhëtare,  
as të trokas papushim,  
as t'i nënshtrohem ëndrrës,  
as thjesht të paguaj,  
as të vozis kot më kot,  
as të luaj me veten.

Gjeje përse kam ardhur,  
domosdoshmërisht për të dhënë një lajm  
të bukur,  
përse kam krisur, përse kam nxituar,  
përse jam lodhur, përse kam gulçuar,  
pastaj përse kam marrë frymë lehtësisht,  
si një shpallje e nxjerrë prej jetës.

hl. punësorë

## URDHËR PUNE I KLASËS SË TRETË

(motivacion)

Urdhër pune i klasës së tretë

i jepet njohësit të ligjeve të mëdha,

Shtjefën Gjeçovit treemërsh:

pluhur prifti, arkeolog i pluhurosur dhe

atdhetar,

që, si në emrin e vet, e ka pluhurin e dheut

në zemër.

1987



*shkruar*  
MALI

(motivacion)  
Një shpat i malit, yti ishte, mbushur me  
gjelbërime të kaltra.  
Shpati i zhveshur, i gërryer, ku s'flinte dot  
asnjë erë, ishte imi.

Ti luaje, qaje, shkruaje poezi, vjetëroheshe  
përditë si pylli yt,  
unë lindesha përditë, si dita që s'ndalet kurrë.

Ku ta dinim ne që një mal do të na ndante  
edhe i bleruar edhe i thatë.

1988

shqip. den

## KOHA ECËN ME TREN

Koha ecën me tren,  
ka prerë një biletë në një stacion periferie,  
bën ecejakje nervoze në holl.

Koha ecën me tren,  
supet i mbështjell me një shall të qielltë,  
kafen e pëlqen më këmbë ta pijë,  
asnjëherë nuk ha në restorant mondan.

Koha ecën me tren,  
këmbët i shpin në një sallë të paemër  
kinemaje,  
një biletë dhjetëlekëshe ka për stadium.  
Vetëm portieri i një spitali të qetë  
ta ndalojë kërkon, kur shkon për vizitë.

Koha ecën me tren,  
si një bujkeshë e mirë me rrogën e parë.

KOHA ECËN ME TREN

*Koha ecën me tren.*

*Askush s'e pret,*

*askush s'e përcjell,*

*dhe askush s'e ka parë.*

1989

ET Y D

Gëten në çantë, jakën pak sport,  
me hijen time dielli po lot.

U shfaq një fletë nga libri i tij  
në trotuar po ec një fëmijë.

Një fije bari, një zog përtej  
dhe pak më poshtë një trung i prerë.

Në çantë Gëte, pak poezi —  
dielli lexon librin e tij.

1987

1987



*dore*

## MË MORE PËR DORE

Më more për dore dhe më the:  
Nata nuk fsheh asgjë përveç ne të dyve.  
Kapërceje atë si një kalë të zi.

Më more për dore dhe më the:  
Nuk vijmë as prej vdekjes në jetë si  
Kostandini te Garentina,  
As prej jetës në vdekje si Virgjili te  
Beatricja.

Më more për dore dhe më the:  
Jemi më të lashtë se vdekja vetë  
Dhe më të rinj se vetë jeta.

Më more për dore dhe më the:  
Jemi vetëm ne të dy, ne të dy, ne të dy.  
Kapërceje këtë natë, si një kalë të zi.

1985

MEMORANDUM SHËRIMOR I SHËRITËS M  
• • • •  
✓

Në moshën time je ti, tokë,  
që mban fshehur farën e të gjitha gëzimeve,  
pylli yt edhe druri më një zgavër të re  
ku troket qukapiku,  
rrethi i ri i lisit tënd,  
gjethi i tij i pjekur.

Në moshën time je ti, tokë,  
me këmbimin e katër stinëve.

Kemi ardhur dalëngadalë  
në kohën tonë të përjetshme.

1988

✓  
MË SHTRËNGON DHJETORI NË ZEMËR

Atje lart, si në qiell,  
Një fëmijë i mbështjellë me dritaren,  
Një dorë e vogël kërkon rrugën e madhe.

Në trotuar dy mjeshtra shpinëvjetër  
Tak, tak, tak, tak, rregullojnë shtegun.

Do të ecë viti, do të shkelë atje koha patjetër,  
Më shtrëngon dhjetori në zemër.

*u. sh. sh.*

## NËNËS SIMË MARGARITË

*E vetmja Margaritë e universit,  
e shkëputur jo nga lulet, as nga yjet, por nga  
njerëzit.*

*E vetmja Margaritë e kësaj bote,  
monedhë e pagjëndshme me të cilën mund  
të blesh jetën.*

*E vetmja Margaritë aq e pasur me gjithçka,  
njëqind trimëri dhe s'e çan dot mes për mes.*

*E vetmja Margaritë e dashurive të mia,  
me emrin nënë të veshur si fundin e gjerë  
dhe të gjatë të shtëpisë.*

*E vetmja Margaritë e livadheve, kalave,  
hapësirave  
trari i kërrusur i shtëpisë, për të kuptuar  
shpejt drejtësitë.*



SHKËMBIMET E MARGARITË

*E vetmja Margaritë e universit,  
ta quash nënë është tepër pak dhe tepër pak  
ta quash thjesht njeri.*

*E vetmja Margaritë e universit,  
një dimension i tij.*

# NISJA

Në hapat e parë u nis të këputë luledelen e  
vogël,  
edhe pak edhe pak, derisa e mbajti i lumtur  
në duar,  
sepse lumturia kërkon të rreshtohet e para  
në jetë.  
Pastaj, përherë të parë i dhanë të mbante  
një qelq me ujë të kulluar.  
Edhe dielli, i përsëritën, është një gotë e  
mbushur  
që ecën pa pushim.

Pra, ki guxim, nisu,  
gjithnjë do të ketë si në përrallë, si në të  
vërtetë  
një njeri që do të kërkojë ujë prej teje.  
Ec edhe pak, edhe pak, të lumtë,  
nesër, pasnesër, kur të jesh burrë i pjekur,  
të shuash etjen e atij që të pret.  
Sepse lumturia kërkon të derdhet e para  
dhe të mblidhet pa u thyer në një qelq.

*Prof.*  
SHTËPIA E PLEQVE

*Shtëpia e pleqve. Numri i telefonit 68-68.  
I rrumbullakët, I butë. I kërrusur si shpina  
e tyre.*

*I saktë.*

*Thonë se atje dikur paqen e shpirtit  
rrëmihnin dervishë gjithfarësoj.*

*Thonë se ka një lëndinë të bukur, të gjelbër,  
selvi,*

*Diell me tepricë sa për të pulitur sytë,  
Zemra si kashtë që digjen papritur.*

*Shtëpia e pleqve. Numri i telefonit 68-68.  
Më sipër shtëpia e foshnjës. Më poshtë diçka  
tjetër.*

*Infermiere që grindet përse bie kjo zile  
kështu papushim,*

*Hapa të ngadaltë që kurrë s'arrijnë të afrohen  
me atë që ju flet nga larg.*

*68-68, përkulur nga era e selvisë, e barit  
rreth e qark.*

1987

KËNGË TJETËR

Trupi im është një humnerë,  
prej tokës thellë e më thellë,  
s'e di kush duhet të bjerë,  
të flerë.

Të flerë dhe të zgjohet me ëndrra,  
të shohë pa fund se ç'ka brenda,  
të ngrihet me shkallë te zemra.

Të ngrihet me shkallë te zemra,  
të ngjitet si zog të kapë qiellë,  
të vritet dhe prapë të bjerë.



## ËNDRRA

*Vajzë e vogël,  
gjuri i vrrarë si harta e botës.  
Një pikë loti.*

*Buka me gjalpë,  
shkallë të zakonshme që s'gjarpërojnë  
ëmbël.*

*Sikur pas shekujsh  
të më uleshë në ëndërr!*

1989

*dash*

## KUR QAJ ME TY EDHE KUR QESH

*Kur qaj me ty edhe kur qesh,  
jam e kaluara ime unë, e kaluara jote ti,  
njësoj si drita që kemi përreth,  
kushedi prej sa kohësh të ikura.*

*Njësoj si drita që kemi përreth  
kanë ardhur tani fjalët dhe heshtjet e  
dikurshme pa fund.*

*Nga janë nisur vallë, nga çfarë dite mes nesh,  
që ka mbetur diku.*

*Njësoj si drita e bardhë që na zgjon,  
e shuar diku për të ndezur jetën tek unë.  
Të thyer si drita, ne të dyve dashuria na  
kërkon,  
të jetojë përsëri, ajo që ka humbur.*

*Desh.*

V A L S

Shqiponja e zezë zbriti  
deri te foleja e një gushëkuqi të vogël.  
Gushëkuqi i pranverës rrahu krahët  
drejt folesë dimërore të shqiponjës.  
Poleni i verdhë i limonit ra  
deri te pisha e gjelbër.  
Pluhuri i pishës së gjelbër  
erdhi gjer te deti i kaltër.  
Deti i kaltër lëvizi  
deri te krahët e gurit.  
Krahu i gurit arriti  
deri tek emri im.

Vetëm ne të dy s'dinim të luanim vals,  
as mirëkuptim.

## KËNGË E NATYRSHME

Në qoftë se e natyrshme është e qeshura — si  
valë lumi,  
të qeshim që të shkojmë në detin tonë  
përrallor.

Në qoftë se e natyrshme është dashuria — si  
një pemë e mbjellë,  
të dashurojmë që të ketë gjithmonë  
fëshfërima.

Në qoftë se e natyrshme është lodhja si  
e nesërmja,  
të ecim gjithmonë në pakthim,  
pa të qeshurën artificiale, pa dashurinë  
artificiale,  
pa fjalën artificiale, pa kohën e krijuar  
artificialisht,

Do të ndihemi kështu nga lodhja e madhe  
të natyrshëm njëqindfish.



*desh.*

## RINIA E PARË

*Atë ditë u ndalëm. Donim të putheshim.  
S'u puthëm, u ndamë.*

*Praga qe larg. Bitëllsat. Minifundi.  
Gënjuheshim më pak. Besonim të duheshim.*

*Gjenim një ekran televizori. Nuk shihnim.  
Habiteshim. Se si duheshin me zër.*

*Arrita përsëri pranë buzëve të tua si pranë  
një horizonti.*

*Para teje kisha puthur gjithë botën.*

*S'shkoja dot më tej.*

ME PËLQEN TË SHËTIS

Më pëlqen të shëtis  
e harruar nga vetja,  
e tejdukshme si tis  
midis blirësh dhe plepash.

Më pëlqen që të ndal  
dhe të shfaqem panjohur  
mbi të heshturin bar  
dhe mbi heshtjen e zogjve.

Më pëlqen që të jem  
e trazuar me jetën,  
e ulur në stol  
me kopshtarin e vjetër.

Më pëlqen që të them,  
pa fjalë, pa ligje,  
atë që rrëfen  
pranvera dhe dimri.

34  
22/5 1/2

16  
24

MË PËLQEN TË SHËTIS

Më pëlqen që të ndiej  
sa më do e vërteta,  
që ka ngritur fole  
nën këto degë të gjelbra.

1989



shap  
MËNGJES

Dita është ngritur në majë të gishtave  
të të shohë ty duke fjetur.

Si gjithmonë, sapo të dalësh prej ëndrrës,  
mos harro, hapin e parë drejt luleve të prera.  
Ndërro ujin e vazos së bardhë  
që të rrojnë edhe një ditë trëndafilat,

pastaj ik.  
Karafilin e bardhë hidhe ose, po të mos kesh  
kohë,

le ta durojë trishtimin edhe një ditë.  
Mos harro asniherë nërin e ri, të freskët,  
oë netalet të mos bien sot, po nesër.  
Që të mos tronditësh vazën oë mban në duar,  
ec naadalë, si mënqjesi vetë.

Kthehu pastaj dhe gjej një aspirinë, thërmoje  
me kujdes,  
lulet të vazhdojnë të flenë.

Pastaj dëgjo trokitjen e diellit pafund  
në dritaren e hapur  
dhe lëre ujin të rrjedhë, në fytyrën tënde.



*dash*

## TI GJITHMONË JE JASHTË MEJE

*Ti gjithmonë je jashtë meje,  
në të tjera lëndina, në të tiera rrugë.  
Të dashurosh, do të thotë të ecësh.*

*Ti gjithmonë je larg meje,  
naukur sytë në një nikë të fshehtë horizonti.  
Të dashurosh, do të thotë të shfaqesh.*

*Ti gjithmonë je tej meje.  
Të dashurosh, do të thotë të kthehesh.*

## UNË DHE KOHA

Tani çuditërisht s'kam nevojë për akrepat e  
orës,  
tani e ndiej se orët, minutat, sekondat i gjej  
vetë,  
kjo do të thotë se ditët që kanë shkuar  
kanë rrjedhur edhe përmes meje.

Tani çuditërisht s'kam nevojë as si barë  
të shoh vjet.  
as kohën ta mat me dridhiet e vëmëve,  
minutat, sekondat i kam nëpër dej  
dhe prapë rrjedhin prej meje.

Tani çuditërisht s'kam nevojë të vë zilen  
e orës si fëmijë,  
dalëngadalë kam filluar të mas kohën me  
veten  
e trembem që kaq shumë naa jeta kam fituar,  
kjo do të thotë që shumë do të kem humbur  
patjetër.

Tani çuditërisht s'kam nevojë të mas shekujt  
as me rrathët e lisit.

*shumë më tepër zbres sesa shkallët që kam  
në ballë.*

*Dhe jam ai njeriu i parë i botës,  
që kohën e ka marrë në krahë.*



*Asht*

**NË ËNDËRR ASNJËHERË S'TË KAM  
PARË**

*Në ëndërr asnjëherë s'të kam parë.  
Ndoshta nuk vjen ti në një botë irreale.*

*Ndoshta as ke trokitur, as ke kërkuar të hysh,  
Lëndinat ku kemi qenë janë ëndrra  
njëqindfish.*

*Po as lëndinat tona, asnjëherë nuk i kam parë  
në ëndërr,  
Në një botë krejt të huaj, gjithnjë atje  
gjendem.*

*Asnjëherë në ëndërr nuk kam parë as cigaren  
tënde të shuar,  
As tymin që mbështillet si një trup i bardhë  
fëmije.*

*Kjo do të thotë se trembem të të dua  
Në një botë marrëzie.*



*Diop*

## EPITAF NË VARRIN E NJË BUROKRATI

PARË

*Përveç njeriut asgjë në botë nuk di të thotë  
as gjelbërimi, as lulja e vogël, as kjo  
sikur të ishin si ty zyrtarë.*

PEIZAZH

*Asgjë të vjetër s'ka përreth,  
po shoh veç pemën që po flet,  
po shoh përtej velën e resë,  
që diku shkon dhe s'kthehet më.*

*Asgjë të vjetër s'ka përreth,  
krahu i barit mugullon,  
vështrimi i syrit të rrëshqet  
dhe diku zhduket si një zog.*

*Asgjë të vjetër s'ka përreth,  
nuk ka as fjalë të mëdha,  
në botë ka veç të vërteta  
dhe asgjë tjetër më nuk ka.*

## GALERIA

Paratë prishen në fund të vitit,  
po unë s'pëlqej kaq llogari.  
Shfaqjet pëlqej që vijnë dhe ikin,  
e ulur jam në galeri.

Më duket vetja e hutuar,  
në galeri, në galeri,  
Këtu shumë jetën e filluan  
po s'e mbaruan kurrsesi.

Të tjerë u rrudhën, në plate shkuan  
dhe me rininë më s'maten dot.  
Qeshjen dhe fjalën e shpenguar  
ta vjedh kam ardhur ja ta marr borxh.

1988



LÛTJE PËR NËN LEHAR KËR  
PËR SAKRIFIKIMIN

Kafeja e derdhur,  
kafeja, kafe,  
furnela e bardhë,  
i bardhë porcelani.

Miku i ëmbël,  
me pak sheqer,  
sheqeri i bardhë,  
kafeja e zezë.



LUTJE PËR NJË INTERVISTË TË RE  
PËR SAKRIFIKIMIN

Kështjella e Rozafës rri e qetë  
me flokë qiejsh që dridhen pa pushim,  
dhe meqë muret s'dinë të flasin vetë,  
ju lutem të flas unë ç'do të thotë sakrifikim.

«Sakrifikim nuk është sakrificë,  
sakrifikim — një shkëlqje me themel,  
boshllëk i zemrës — ekran i historisë,  
ku edhe unë dua diç të them.

Sakrifikim — ku lule mbijnë patjetër,  
vazo e zemrës që për të tjerët çel,  
sakrifikim — tek gjaku rrjedh i vjetër,  
pagjumësi që ngrihet si kështjellë.»

Përse u kujtova sot për herë të parë,  
të flas dhe të mendohem thellë për të?  
Harrova, shokë, të shoh fytyrën time  
në intervistën mbrëmë në TV.

1988

*Shqipëria*

ORA E FUNDIT  
DASHURIM SHQIPJAS

Shqipja, e kreshpëruar, e lirë për të kapur  
aq sa edhe qiellin asnjëri nuk ia mat.

Zog i bukur në fluturimin tënd,  
të paparashikuar nga dijetarët dhe  
e butë si dhembja e vdekjes,  
e egër si gëzimi.

Qielli është një dhe ajo është një.  
Zog dhe gjuhë e pavdekshme  
që fluturon buzë më buzë.

Brëkullisi me këmbë deri te porta një  
guri të vogël,  
liste me tal



*dash*

DASHURINË TËNDE SHKRUAJ

PER SAKRIFIKIMIN

Sa pak, sa pak një fletë e bardhë,  
për të shkruar dashurinë tënde,  
kur në qiellin e hapur pareshtur  
zogjtë me fluturimin e tyre shkruajnë  
fjalë që vetëm ne i dimë.

Dhe unë  
dashurinë tënde shkruaj.

Kur pemët, fjalë që i besojmë  
vetëm ne të dy, pëshpërisin.

Dhe unë dashurinë tënde shkruaj.

Edhe lumenjtë gërryejnë tokën e lashtë  
për të gdhendur fjalën time të pafundme

për ty.

Sa pak dinim të thoshim në atë fletë të vogël.

*Shog*

ORA E FUNDIT

Nuk e dimë si iku, nuk e dimë,  
qeshte kaq shumë, ishte kaq mirë.

Bleu tri bileta për koncert,  
kishte oreks.

Disa herë ktheu kokën të vështronte  
rrugës një fëmijë,  
iu duk sikur ishte i tij.

Rregulloi këpucët,  
kërkoj bojë për to,  
bile edhe xhela.

Rrokullisi me këmbë deri te porta një  
gur të vogël,  
fliste me ta!



*Ngriti një gotë,  
donte të pinte një fuçi,*

*S'kishte më fuçi.*

Një vit do të thotë të jesh një det.  
Doli hëna, doli dielli dhe më ndanë copë-copë,  
Më thyen si një prizëm të vogël.

Një vit do të thotë të jesh një det.  
Tani dielli më tërheq nga ana e tij  
Hëna nga ana tjetër;  
Më përpara këtë s'e dija.

Një ditë ishte, kur në xham trokiste mjeçulla  
dhe jashtë s'kishte asgjë.  
Një ditë ishte, kur në xham trokiste mjeçulla  
fjalët tonë, fjalët tonë, mjeçullatë.  
Fjalët tonë të dikurshme, të kthjellta.

hap  
KAFENEJA E PALLATIT TË KULTURËS

Të gjithë ishin ulur karshi njëri-tjetrit  
po në ishim ngrirë përballë.  
Vetëm fjalët tona kishin vdekur  
dhe ishin ringjallur.

Ngriheshin, midis nesh kërkonin të jetonin  
dhe prapëseprapë asnjëra nuk dukej e  
rreth e rrotull të tjerë shqiptonin  
fjalët tona të dikurshme, të kthjellta.

Fjalët tona të dikurshme, të kthjellta,  
fjalët tona, fjalët tona, megjithatë.  
Një ditë ishte, kur në xham trokiste mjegulla  
dhe jashtë s'kishte asgjë.



\* \* \*

Mbrëmja është një derë e madhe  
nga kaloj drejt natës,  
nata është korridor pa fund  
ku ec për të takuar ditën,  
dita është një dhomë e pastër  
që ka për dritare qiellin,  
qielli është një xham i tejdukshëm  
që thyhet kur ec.  
Çudi, nuk kam çati  
as mbrëmje, as mëngjes.



E shumëfishuar jam  
si gjethja e gjelbër,  
çelem në një skaj,  
kur në një tjetër zverdhem.

1986

*familjes*

SKENË FAMILJARE

Shihe këtë qiell sa i bukur është, tha burri,  
sa i bukur është, — tha gruaja.  
Dhe kjo derë sa e sigurt është, tha burri,  
sa e sigurt është, tha gruaja.  
Shihe këtë dorë sa e fortë është, tha burri,  
sa e fortë është, tha gruaja.  
Dhe fjala sa e ngjashme është, tha burri,  
sa e ngjashme është, tha gruaja.  
Kjo është familja — tha burri,  
kjo është famë — hilja — tha gruaja.

Duhen këto qiell sa i bukur është,  
sa i bukur është, — tha gruaja.  
Dhe kjo derë sa e sigurt është,  
sa e sigurt është, tha burri.

Të bukura derë sa e sigurt është,  
sa e sigurt është, tha burri.  
Shihe këtë dorë sa e fortë është,  
sa e fortë është, tha gruaja.

Ym

## NJË POEZI QË S'MBARON KURRË

U ndërruan kohët me detergjente,  
makina larëse shiten çdo ditë,  
po shkuma e bardhë që mbulon duart  
të fshehur ka gjithë poezitë.

Dhe heq unazën, heq dhe orën,  
si mijra gra, si mijra gra,  
duhet kjo shkumë të na bashkojë  
nga largësira të mëdha.

Duhet këto duar skuqur, fryrë,  
që ndejnë rrobat në një varg,  
një poezi që s'mbaron kurrë  
dhe që lexohet pak nga pak.

Të bukurat duar, të shenjtat duar,  
kur më në botë nuk ka shenjtorë,  
më rrjedh ngadalë shkuma e bardhë  
dhe poezia zë pikon.



Gjener

# CELET E PAFUND GJITHËSIA

Me qiellin shkrihen vitrinat,  
trotuaret, malet e larta,  
çelet e pafund gjithësia.  
Kur krijon njeriun,  
gruaja bëhet motër  
e rruzullit të rrumbullakët.

1976



## EMRA TË ENDUR NË KALTËRSI

*Emra të endur në kaltërsi,  
njëri i Mërgimtarit të Madh  
që vetëm nga gjaku im nuk mërgon,  
tjetri i së Bukurës së Tij  
vrrarë në një jetë të gjatë pa skaj,  
i treti, Djali i Vogël i përrallës së tyre,  
që plumbi e mori si birin e vet.*

*Emra të endur në kaltërsi.*

*Në kurbën e madhe midis maleve dhe deteve  
nuk u dëgjohet më as hapi, as pëshpërima,  
në pasqyrën e pafundme të kohës asnjëri më  
s'i sheh,*

*kalin më s'e kanë, as navllon e udhëtimit,  
as duvakun, as armën e vjetër.*

*Emra të endur në kaltërsi,  
gjejnë malin dhe zbresin, ngjiten në trupa  
pemësh dhe lulësh dhe ikin,  
dhe enden ende pa i marrë njëri,  
emra të endur në kaltërsi.*

## KUJTESA

### Nerudës

Ja ku është Kadareja, ja ku është Agolli,  
po njeriu ngandonjëherë ka kohë më tepër  
të bisedojë kur rruga është më e gjatë.

Te ti duhet të kapërcesh kontinentin  
dhe oqeanin dhe rrymat e tij,  
ke kohë të flesh, të zgjohesh.  
Ndërkaq, do të jenë shkruar  
disa poezi, disa minuta filmi  
do të jenë xhiruar rreth botës,  
ndërsa unë jam një udhëtare  
që s'bie fare në sy me valixhen time  
në këtë ecje pafund.

Dhe në valixhen time kam futur si zemër  
një vjershë të vogël për gjyshen.  
(E lehtë është valixhja sa një pupël zogu,  
sepse gjyshja ime është kthyer në pluhur.)



Nëndës

Më thua j tani,  
 ç'kujtesë do të kisha unë për t'u kthyer  
 prej teje, pastaj  
 pa të  
 në shtëpinë time të vjetër sa koha.

Ndërkaq do të jenë shkruar  
 mijëra poezi, mijëra minuta filmi  
 do të jenë xhiruar rreth botës.  
 Dhe kjo vjershë për kujtesën,  
 ose gjyshen, ose pluhurin e artë,  
 që si rrugë është shtrirë në këtë ecje të gjatë.

*lemp.*  
ZH D U K J A

Larg, larg, larg,  
as në Nevadë, as në Misisipi, as në Masaçuset,  
larg, larg, larg,  
ku asnjeri nuk e di,  
larg, larg, larg  
lëndinave, autostradave, fushave për  
hendboll,  
larg, larg, larg,  
atje ku nga pluhuri i kuq ka mbirë trëndafili  
i zi,  
larg, larg, larg,  
gati në eter, gati në pafundësi  
atje ku nuk arrin asnjë zë,  
larg, larg, larg  
ku s'ka më as Uitman, as Heminguej,  
larg, larg, larg  
nga oqeani i vetes përtej  
ndodhet si një copë buke e vdekur,  
një varr,  
që askush nuk e gjen.



*Gjysh, o gjysh i paparë, i humbur, i zhdukur  
deri nga vdekja  
i nisur dikur për të ushqyer dy tri gojë të  
jetës...*

*Do të doja të vazhdonin ta hanin  
atë bukë të vdekur  
vetëm trëndafilat.*

## TË ZHDUASH

*I thashë vetes një herë,  
hiqe pluhurin e dashurisë.*

*Hiqe pluhurin e rëndë të mbetur,  
njësoj si nga nata të heqësh  
shkëlqimin e hënës së argjendtë.*

*Hiqe si plugun e harruar  
që deri tash ka bërë të lulëzojnë  
gjithë bimët e bukura.*

*Më gjatë se sa pafundësia.*



## NJERIU I RREGULLT

*Njeriu i rregullt e di gjithmonë,  
kur duhet t'i vërë dorezat e dimrit  
(sikur të ishin vetë dallëndyshet bishtgërshëra  
që vinin).*

*Datat mban mend kur i ka nxjerrë nga sirtari  
dhe kur i ka futur në sirtar,  
(sikur të ishin letra dashurie).*

*Letrat e dashurisë i ka grisur,  
por dallëndyshet s'i ka vrarë,  
në vend të tyre një palë doreza dimri  
ka ruajtur në sirtar.*

*slup*

## SA HERË MARR NË DORË NJË MOLLË

*Sa herë marr në dorë një mollë,  
më kujtohet aktori Jani Riza.  
Daç më besoni, daç mos më besoni,  
që as vdekjen s'e dinte  
duke ngrënë rrugës krrap-krrup një mollë  
Bulgareci.  
Nuk ishte aq i madh dhe i pavdekshëm,  
po vdekjes nuk do t'i kishte dalë në takim  
kurrë  
po të mos ishte ajo aq e verbër.*

*Ecte drejt, i posandarë nga një kopsht me  
mollët e tij të vendlindjes,  
pa e ditur që kishte një tjetër që ecte  
shtrembër  
dhe kështu aksidentalisht e paguam të gjithë.  
Shumë shtrenjtë është të paguash me një  
njeri, Jani Riza.*



*1/2/4*

## DUART E TUA TË FTOHTA

*Duart e tua të ftohta,  
të ftohta,  
oh.*

*Duart e tua të ftohta,  
të ftohta,  
gjuhë dhe gjah.*

*Duart e tua të ftohta,  
të ftohta,  
nga afër dhe larg.*

DHE RRJEDH NJË LUMË PA PUSHIM

*Dhe rrjedh një lumë pa pushim...  
Mbi një gjethe të vogël, të vogël,  
lundroja për të gjetur  
brigje të tjera të vetes sime.*

*Dhe rrjedh një lumë pa pushim...  
Lumi i kohës dhe lumi i vetes  
bashkohen në një ditë.*

*Dhe rrjedh një lumë pa pushim... :*

*Tani ku kam hipur vallë,  
në ç'gjë të pashpikur  
për ta kapur.*

*dadi*

E DOT ZOGU S'DO TË HYJË  
NË BOTËN TONË TË VOGËL

*Erdhi koha të duhemi.  
Dera u mbyll e qetë, e vajisur,  
Saqë duket sikur nuk do të rënkojë kurrë.*

*Kanarina braktisi folenë,  
për shkak të asaj dëre që s'e mbyllnim dot  
pak më parë.*

*Erdhi koha të duhemi.  
Dera u mbyll e qetë, e vajisur,  
E dot zogu s'do të hyjë.*

*dash*

KA DIÇKA TË RËNDËSISHME  
NË QENIEN TIME

*Ka diçka të rëndësishme në qenien time,  
që dot s'e gjej, sado që ta kërkoj nëpër  
ëndërr.*

*Ka diçka të rëndësishme dhe të pakapër-  
cyeshme në qenien time,  
që më bën të ndaloj dhe të të vështroj ty në  
zemër.*



UDHËTIMI SHQIPTAR

*Trupi im si një bohçe*

*rrugëgjatë*

*Ku kam mbështjellë zemrën*

*si bukën.*

Gjithë sa kam qenë, në dimër, vjeshtë,  
në këtë qytet prej mrekullish  
me shpirt liqeni aq të kthjellët,  
një ditë ish, një ditë ish.

Një ditë ish, çka iku, çka shkoi,  
vjollca e çelur nëpër valë,  
zogu që pret të fluturojë,  
varka e vogël që zemrës kam.

Një ditë ish, një ditë ish,  
gjithë sa koha më mbledh në duar,  
as qetë unë dhe as furishëm  
dhe një liqen i pashpjeguar.

## GURËT E VEZUVIT

Zjarri i lavës, vdekja, qyteti i rrënuar,  
pemët e zhuritura, tmerri, fjala e lënë  
përgjysmë,  
kthehej çdo gjë ngadalë në akull të zi,  
flinte bilbili, flinte lauresha në një gjumë  
të mynxyrshëm,  
dhe monedha e shndritshme për blerje  
stolish.

Shkundej lava e ftohtë e vdekjes,  
binte nga supet e barit të djegur,  
nga buzët e dashurisë, nga klithma e luftrave,  
të tjera kartmonedha u shtypën mjeshtërisht  
dhe të tjera fate.

Të tjerë njerëz erdhën, u ndërruan,  
të lumtur prekin lavën e zezë si gur,  
tani ju pëlqen si stoli ta blejnë për duart,  
ta mbajnë si ogur.

1986

76



## NAPOLI

*Napoli, një garzë buzë detit  
hedhur për t'u larë,  
e vjetër mijëra vjet,  
mbështjellë mijëra plagë.*

*Nuk dihet të plagosurit  
në ikën, në jetuan.*

*Asgjë nuk thonë valët,  
asgjë nuk thonë pëllumbat.*

1986



A PRISHTINË, E ZHURMASHME  
PRISHTINË

*A Prishtinë, e zhurmshme Prishtinë,  
teatri luan klimë kontinentale.*

*A Prishtinë, e zhurmshme Prishtinë,  
në thinjat e tua dimërore rrëshqasin fëmijët.*

*A Prishtinë, e zhurmshme Prishtinë,  
livadhet e tua i var kasapi.*

*A Prishtinë, e zhurmshme Prishtinë,  
lulet çelin në një pranverë të pangjashme.*

*A Prishtinë, e zhurmshme Prishtinë,  
teatri luan verë edhe dimër.*

## PROTESILAU 9

*Nata po bie përçark si shi,  
Protesilau, të vij, po si?*

*Kam ecur shumë, trokas që larg,  
Protesilau, tak-tak, tak-tak.*

*Trojë më s'ka, Agamemnon,  
Protesilau, a më dëgjon?*

*Tani ec kohës me një taksi,  
Protesilau, periferi.*

*Është shtrirë rruga a një ushtar,  
Protesilau, askush më s'qan.*

*Kinema «Laura» përmbi ty qesh,  
Protesilau, ti s'e merr vesh.*

---

Protesilau 9 — adresë në Athinë.

*Ti s'i merr vesh dhelet e saj,  
Protesilau përjetë i vrarë.*

*Përjetë i vrarë nga një dardan,  
Protesilau, prej tij unë jam.*

*Homeri plagët nuk t'i fsheh,  
Protesilau, të gjallë ne.*

*Ti rrugë e thjeshtë, unë udhëtar,  
Protesilau, kaq mall i madh?*

*Troja filloi me ne të dy,  
Protesilau, më lër të hyj.*

Protesilau 2 — adresë në Athinë

✓

DUKE U LARGUAR NGA ELADA  
AQ E VJETËR

Duke u larguar nga Elada, deti ishte i  
Homerit,  
gjoksi i ishte kthyer limer për të mbledhur  
anijet  
dhe krahët në dy pista të vjetra prej nga  
niseshin avionët.

Sa më shumë shkëputesha prej tij,  
shtëpitë që mbeteshin larg,  
u ngjanin foleve të bardha të ngritura nga  
zogjtë.

Duke u larguar nga Elada, sa bukur, thashë,  
është,  
të çash botën me qerpikët e një vajze të  
bukur përbri,  
dhe varfëria e botës m'u duk si një kuti  
e harruar diku  
në një stacion të vogël periferie.

Duke u larguar nga Elada, gjithë dhembjet  
e reja njerëzore  
m'u kthyen në një fluturim të përjetshëm,



*Ndërsa njerëzit mijëvjeçarë ngulnin jetën  
diku  
në atë rruzull të vogël të magjishëm,  
që vinte të më mbledhej në grykë.*

**1989**

*Step*

POSTA E ATHINËS (PUBLIKE)

*Qëndro në një stol dhe prit,  
po hë për hë ka pak ndoshta karrige.*

*Njerëz ka më shumë dhe telefona më pak  
se ata,  
kalimtarë të Athinës, nëpër rrugë të mëdha.*

*Atëherë qëndro edhe më në këmbë,  
alo, Tirana, të kam parë në ëndërr.*

*Alo, Marçelo, çfarë valësh të nxorën në breg;  
ti voglio bene mama dhe dielli fort djeg.*

*Sa shumë të dua, I love you, darling!  
si anije e ankoruar të kam mbetur në shpirt.*

*Attention, attention, me gurët mos fol,  
dhe me njerëzit si gur, attention, attention.*

POSTA E ATHINËS (PUBLIKË)

*Një jen, dy jen, sa kushton një fjalë  
e të riut e plakut, a janë barabar?*

*A nisen njësoj dhe a çlodhen rrugës pak,  
bota rrotullohet në gjuhën e saj.*

*Ç'është kështu, si mundet kaq thjesht,  
posta e Athinës kthen orakujt në njerëz.*

*Shekulli i Deut*  
*ne botë*

**KËNGË E NJERIUT TË SOTËM**

*Në horizontin e madh të jetës  
si diell ngrihet sot çdo njeri,  
e zgjuan ëndrrat, e zgjuan shekujt,  
e zgjoi vetë histori e tij.*

*Në këmbë kush ngrihet,  
në gjunjë më s'bie,  
asgjë nga rruga e tij s'e kthen,  
si flamur i madh njeriu ngrihet  
dhe askush në botë më s'e gënjen.*

*E zgjoi njeriu të vërtetën,  
në gjumë të thellë nuk kthehet më,  
i zbret liria mu në zemër  
dhe të vetëm s'e lë.*



## PAQJA KU DUKET

*Paqja ku duket,  
shtëpi e gjelbëruar,  
agimi po vjen  
si lajmi i vonuar.*

*Paqja ku duket,  
një grua me fshesë  
fshin shkallët e bardha  
ku burri të zbresë.*

**1989**

NJË DITË PADREJTËSIE,  
QË QUHET VETËM 25 SHKURT

*Dita e sotme e botës, si një shërbëtore e vogël,  
po shkon të përcjellë diku një perandor të  
vjetër.*

*Dita e sotme e botës, si një fije shkrepëse  
e hedhur diku, që asnjëri s'i jep dritë.*

*Kërkoj që ta ndez,  
t'u shoh njerëzve sytë.*

## HOTELI «BOZHUR»

*Hoteli «Bozhur»,  
me emër lulegjaku,  
në një skaj është ulur  
të botës së pamatë.*

*Hoteli «Bozhur»  
ku të buzëqesh kamerieri,  
pronto, sejças,  
hvala, faleminderit.*

*Hoteli «Bozhur»,  
punon ashensori,  
i gatshëm të të çojë  
përtej dimensioneve.*

*Hoteli «Bozhur»,  
të qeta mbeten shkallët,  
Kaq shpejt u zbut  
kjo botë e madhe?*

psal. 90 i leshur  
njëherë

## JETËGRABITËSIT

Në fillim ata thanë thjesht,  
merr nga jeta jote atë që na duhet më tepër,  
të kemi bërë nder, nga ana jote kemi hedhur  
zemrën që ke,  
të gjithë të tjerat, sa shihen, sa s'shihen janë  
për ne.

Ke për të gëzuar sytë e tu, lëkurën,  
ne po të japim gjithçka siç e sheh,  
të kemi bërë nder, të kemi quajtur njeri,  
të gjitha të tjerat, sa shihen, sa s'shihen janë  
për ne.

Në goftë se ti diçka tjetër kërkon  
edhe ne të tjerët do të kërkojmë më.  
Mbi këtë tokë të zezë, nën këtë qiell monoton,  
të gjitha sa shihen, sa s'shihen janë për ne.

Atëherë fare mirë mund t'ju marrim dhe  
kokën,  
si bënte dikur çdo sundimtar mbi dhe,  
s'është gjë tjetër veç një pare e vogël  
dhe të gjitha këto, gjithë të tjerat janë për ne.



E në qoftë se kërkonti përsëri pak më tepër,  
fjala vjen, drejtësi a një fjalë të re,  
të drejtë ne kemi t'ju marrim lëkurën dhe  
zemrën  
se të gjitha sa shihen, sa s'shihen janë për ne.

Pastaj për të pastruar ndërgjegjen tonë të  
vrrarë,  
do të dalim të mbajmë një himn jete fjalim,  
e kush do të dëgjojë atë që ne thamë,  
të gjitha të tjerat, të gjitha të tjerat janë  
për ne.

FAQE FJALORI SHQIP E GRISUR  
NGA MLLICËT

*Lefta me  
Bosova*

**Pabindur,  
padepërtueshëm,  
padrejtësi,  
pallogaritshëm,**

.....

**paqartësi,  
paqëndrueshmëri,  
pastaj  
paq (pastër, plot e përplot, ose mirë)  
paqe,  
paqejf,  
paqenë.**

## VRASJE ENDE TË PAIDENTIFIKUARA

*Vrasje ende të paidentifikuara në një pikë  
të Evropës,  
të shtëna mbi fëmijë, si meny festive.  
Vrasje fshehur nga sytë, sytë mbyllur nga  
plumbat,  
vrasje me gjak, verifikim i përgjakur.  
Kur vritet njeriu, një shkallë më pak ka për  
t'u ngjitur në jetë,  
kështu thonë gazetatat.*

*Vrasje në prag, vrasje në dritare, vrasje në  
biçikletë,  
të qara ka pak, po kjo s'do të thotë se s'ka  
vdekje.*

*Po ata, po ata që prapë mbetën gjallë,  
dhe ecin një nga një si kalimtarë të vetëm,  
meqë rrojnë, thonë, prapë i harruan gazetatat,  
të gjallë janë ata, për të zëvendësuar të  
vdekurit.*

Vrasje ende të paidentifikuara në një pikë  
të Evropës,  
të shtëna mbi ata që kërkojnë vetveten.  
Po ata që i vranë duke i puthur me vdekjen,  
të vdekur janë ata për të zëvendësuar të  
gjallët  
në statistikat e gazetave.

1989



SHOKËT

Një mijë herë mbështes kokën time  
mbi supin tuaj të lodhur,  
një mijë herë vij t'ju puth ballin e bardhë,  
zbres te vetullat burrërore që dinë të fshehin  
një mijë inate dhe një mijë fjalë të heshtura,  
një mijë herë vij të ulem te pellqjet e  
turbullta të syve,  
një mijë herë ju prek buzët e ftohta si  
burimet,  
fytyrën tuaj të skalitur nëpër të cilën  
jeta gjen rrugën e zemrës.

Pastaj përkulem të arrij duart tuaja të  
varura,  
në trungun e etur,  
(e ndoshta për këtë më duhet një shekull)  
një mijë herë lidhem tek ato duar  
nga nis vrap si fëmijë gjuha jonë e ëmbël.

Një mijë herë vij ju takoj atje ku jeni,  
mbetem,  
ju them që tani të më përfytyroni kështu,  
kur të më shihni para jush  
të ngurosur nga malli.

## NDARJA

Përse të desha kaq ty, qytet i purpurt verior.  
Përse të desha kaq, kur vetëm ajrin të pata?  
Tymi i ëndrrës të zbriste përposh,  
si në Korçën time të largët.

Si në Korçën time të largët  
m'u duk rruga qendrore, me blirë, me erë,  
me zogj,  
dhe pranvera që thëthinte balta.  
Përse të desha kaq, përse s'të putha dot,  
në heshtjen tënde të artë.?

Përse s'të putha dot, përse të ika,  
pa e ditur se ç'po ndodhte atë mbrëmje?  
Si të të puth tani ty, moj Korçë?  
Thashë atëherë me dhembje.

1974

KORÇA, KORÇA *notja*

Muzgu, një pemë jargavani mbjellë  
në pragun e shtëpisë  
Dy palë muret me gëlqere të rrugicave  
ngjasin me krahë pëllumbi.  
Në fletore të pastër janë kthyer  
rrugët e posambuluara me borë.

Pas pak do të bjerë nata.  
Dhe qielli do të bëhet blu nga një kallamar  
shkrimi  
i derdhur prej një vajze të vogël  
që rrëshqet në akull  
e që më thotë shkruaj.



## NATYRË E QETË

*Jeta ime prej gruaje  
ka vizatuar në hapësirë natyrën time të  
një libër të bibliotekës, një laps, ca fletë  
dhe një gjilpërë të vogël për të qepur.*

*Kur librin marr për të lexuar,  
ose kur në fletë me ju flas,  
e vetme mbetet gjilpëra ime e pruaruar  
në hapësirën e madhe.*

*Mos pandehni se atë do ta humb,  
Në çdo gëzim dhe çdo dhimbje  
ta dini që ndjeni në zemër,  
atë gjilpërë të vogël të padukshme të gruas,  
në mes të kësaj bote pa anë e pa fund.*



## ERË BORZILOKU

### OSE

KËNGË E FUNDIT PËR ATË QË MË  
TREGOI PËRRALLËN E PARË

### KËNGA E PARË

*Asnjëri nuk ia dinte ditën e saj të parë,  
thonë se edhe emrin ia sollën të mbështjellë  
me një shami të vjetër,  
thonë se nuk mbretëronte askush atë ditë,  
as era, as shiu, as krisma, as mbretër,  
thonë se ishte ditë borziloku,*

*Thonë se ishte një ditë borziloku  
dhe trupi i saj një bisk i mbjellë.*

*As moshën tashmë s'ia dinte njeri.  
Thonë për të 99,  
thonë 101.*

*As emrin e saj si kohën e saj nuk dinte ta  
shkruante dot,  
as fatin e saj nuk e fliste asnjëherë,*

e mbeti vazhdimisht e mbështjellë me shallin  
e zi të natës.  
Nuk ishte as gjyshe, as nuse, as grua, as  
motër, as bijë  
ishte perde e varur në teatrin e njerëzimit.

Flinte, çohëj, rrinte para nesh e menduar,  
e rrethuar gjithnjë nga një emër borziloku,  
vraponte në livadhe imagjinarë,  
lëkundej e vogël në një degë kumbulle të  
hidhur,

ecte dejt nesh pastaj reale.  
Në çdo lëvizje të duarve të saj, të buzëve,  
të syve,

si perde njëshekullore,  
hapte dhe mbyllte teatrin e madh.  
Po të donte ajo shihnim në atë që ikte e  
kishte ikur,

po të mos donte ajo kurrë.  
Kapedanët zhurmëmëdhenj, shpatat,  
plumbat,

mitralozët, televizorët, balerinat  
vinin të zinin vend në skenën e saj,  
po të donte ajo këndonin bilbilat  
dhe po të donte ajo qanin.

## KËNGA E DYTË

Tani vrapon një fytyrë njëqindvjeçare drejt  
rinisë



si vrapon deti te brigjet,  
valë buzësh dhe valë sysh,  
valë buzëqeshjesh të ikura  
kërkojnë njëra-tjetrën.

Inde të posavdekura, anije vigane.

Kërkon t'i çojë të gjithë në zenitin e saj,  
drejt furtunës së saj më të bukur,  
drejt dritës së saj më të bardhë,  
sepse edhe zenitin asnjeri nuk ia di.

Dhe vjen më në fund aq e bukur  
me fytyrën e dikurshme që asnjë nga të  
sotmit s'ia ka parë.

Me fytyrën e dikurshme që asnjeri s'ia ka  
parë,

ka kërcyer dikur, ka kumbuar si këngë,  
një shekull të tërë ka ndriçuar si kandil prej  
ëndrre,  
amendamente, memorandume, demonstrata,  
trakte

e zënka në dasma të thjeshta.

Si mund t'i ndriçonte të gjitha ajo dritë e  
vogël,

që tani më shfaqet te zemra.

Perde njëshekullore e varur tejpërtej  
njerëzimit,

që kurrë s'e more vesh që jetonin edhe  
prapaskenat ashtu  
si edhe pranvera dhe dimri.

### KËNGA E TRETË

Kur isha unë sa ty qeshja me një buzëqeshje  
më të vjetër se veten.

Qaja për t'u veshur me rroba të reja,  
si veshin vetëm një të vdekur.

Shihja vetëm një anë të malit  
që bëhej njësoj si rroba ime e vjetër,  
i njëjti pyll, e njëjta lëndinë, i njëjti qiell i  
grisur.

Për mua emrat më të mëdhenj të botës  
ishin emrat e baballarëve,  
vetëm si vetëtima shfaqeshin ca emra a zëra  
të laraët si plagë  
pastaj erdhe ti dhe unë zbulova gjithë  
kontinentet,  
pastaj erdhe ti, pastaj erdhe ti, pastaj erdhe  
ti,

kapërceva 99,  
101,

99 male, 99 dete, 99 oqeanë,  
99 rrëke të shpejta.

Tani dua të kapërcej gjithçka,  
ty po të mbështetem në duar,  
ti po më merr në krah.



Mos u mërzit se si do të thyhem, se si do të  
këputem,

e si do të bie prej teje  
me të gjithë erën e borzilokut të vjetër,  
me të gjithë trokun e kalit të nuses,  
me të gjithë plagët,  
me të gjithë një shekull.

Kur të qeshësh, ta dish  
se njeriu ka një buzëqeshje më të vjetër se  
veten,  
kur të qash, ta dish,  
të ikësh do të thotë të sjellësh një erë të re.

#### KËNGA E KATËRT

Ikën përfundimisht rrezet e një dielli të  
vjetër,  
sado të vraposh nuk e arrin dot më atë  
lëndinë të gjelbër, të mbetur në kujtesën  
e saj.

Iku, u zhduk një qiell i dikurshëm, i vogël,  
i çmuar, si rubini,  
ku yjtë nuk ndritnin, por nxinin.

#### KËNGA E PESTË

Lamtumirë, pjergull e djegur, bistak  
i zhuritur,

*būrim i shkēputur që rrjedh në hapēsirē,  
borzilok erēmirē.*

*Lamtumirē, ankth i ditëve të largēta të  
jetuara prej njeriut,  
të mbetura në trupin e saj si një sēnduk  
i vjetēr.*

*Lamtumirē, heshtje, padurim i shkuar,  
mē s'tē jetoj dot, o ditē e atēhershme  
borziloku;  
të ikësh do të thotē që të sjellësh prej vetes  
njē erē të re.*

*Derisa kishim një stērgjyshe,  
kishim një stērkohē,  
njē stērpemē,  
njē stērlule,  
njē stērborē  
kishim vrapin e pafund dhe të palodhur të  
njē kali të vjetēr  
tani asgjē nuk gjejmē dot,  
u shkull një shekull i tērē që ajo mbante  
me vete.*

#### KĒNGA E GJASHTĒ

*Ngrihemi në mēngjes dhe gjejmē vetēm njē  
lule të posaçelur,  
qē të rritet sa mē shpejt e futim në një serē,*



dielli i ri i shtrëngohet në zemër  
derisa kthehet në polen të verdhë.

Vijnë 99 vite, 101 ta kërkojnë atë lule dhe e  
gjejnë eksperimentalisht midis xhamash,  
ne ikëm, thonë, por kjo s'do të thotë që nuk  
duhen çatitë me tulla të kuqe,  
atje ku ka erë çatitë prej zembrës së malit  
duhen.

Herë i kuptojmë vitet e ikur ç'na thonë, herë  
s'i kuptojmë,

aq shartime lulësh janë bërë  
sa vjen një vogëlush dhe kërkon të dijë kush  
është borziloku.

Borziloku nga erdhi një jetë dhe iku,  
fle tani i qëndisur në gjoksin e një fëmije,

e prenë, e morën, e ngjitën, e vulosën  
në një fabrikë tekstile.

Vetëm po të mbështetësh kokën mbi zembrën  
e dashuruar

e ndien ç'erë bie.

(Asnjeri nuk e di se sa ngjan një bisk  
borziloku  
me konturet e një njeriu.)

## KËNGË MALLI

Prehri yt mbushur me mollë qindvjeçare  
ëndërrore,

tokë e zhuritur ku mbinte borziloku i  
përjetshëm,  
plasa zemre që shfaqeshin, hapeshin,  
mbylleshin,  
ujë që pikonte papushim, pik, pik.

Në njërën anë Tomori,  
në anën tjetër Morava,  
në mes ti.

Si më ike kaq larg, Nënë e Madhe, nënë e  
pafund.

E prapë mali me malin s'u poqën;  
megjithëse, edhe toka u shkund.



## KËNGA E FUNDIT

Lamtumirë, rrugë të gjata me pluhur,  
stërpluhur.  
kambanë e këputur zemre, stërkambanë,  
fytyrë e bukur e një pranvere të shuar,  
stërpranverë,  
lamtumirë çdo gjë e jetuar nga një njeri  
njëqindvjetësh,  
sa më larg më shkon, aq më shumë  
më gjëndesh.

Që të nisem unë larg e më larg,  
larg e më larg më ikën dhe ti,  
Lamtumirë, qiell i sotëm, prag i sotëm,  
motive që deri sot më kishit lindur patjetër,  
erë e re po ngrihet në boshllëkun e madh të  
zembrës.

1986-89

## PËRMBAJTJE

E vërteta (ime) .....	3
Unë .....	5
E para .....	6
Vathët e rinj .....	7
Pritja .....	8
Koha jonë homerike .....	9
Në një aeroport të paemër .....	10
Kthesa e rrugës sime të gjelbër .....	11
Shqiptarka .....	12
Përderisa në jetë kemi gjithmonë diçka të pafilluar .....	13
Rri dhe dëgjoj .....	14
Llogaria .....	15
Koha e lamtumirës .....	17
Ty të gjeta .....	18
Nga retë rrethuar .....	19
Gjeje përse kam ardhur .....	20
Urdhër pune i klasit të tretë .....	21
Mali .....	22
Koha ecën me tren .....	23
Etyd .....	25
Më more për dore .....	26
Në moshën time je ti tokë .....	27

Më shtrëngon dhjetori në zemër .....	28
Nënës sime, Margaritë .....	29
Nisja .....	31
Shtëpia e pleqve .....	32
Këngë tjetër .....	33
Ëndrra .....	34
Kur qaj me ty dhe kur qesh .....	35
Vals .....	36
Këngë e natyrshme .....	37
Rinia e parë .....	38
Më pëlqen të shëtis .....	39
Mëngjes .....	41
Ti gjithmonë je jashtë meje .....	42
Unë dhe koha .....	43
Në ëndërr asnjëherë s'të kam parë .....	45
Epitaf në varrin e një burokrati .....	46
Peisazhi .....	47
Galeria .....	48
Akuarel .....	49
Lutje për një intervistë të re për sakrificim	50
Shqipja .....	51
Dashurinë tënde shkruaj .....	52
Ora e fundit .....	53
Një vit .....	55
Kafeneja e Pallatit të Kulturës .....	56
* * * .....	57
E shumëfishuar jam .....	58
Skenë familjare .....	59
Një poezi që s'mbaron kurrë .....	60
Çelet e pafund gjithësia .....	61
Emra të endur në kaltërsi .....	62



<b>Kujtesa</b> .....	63
<b>Zhdukja</b> .....	65
<b>Të zhdush</b> .....	67
<b>Njeriu i rregullt</b> .....	68
<b>Sa herë marr në dorë një mollë</b> .....	69
<b>Duart e tua të ftohta</b> .....	70
<b>Dhe rrjedh një lumë papushim</b> .....	71
<b>E dot zogu s'do të hyjë në botën tonë të vogël</b> .....	72
<b>Ka diçka të rëndësishme në qënien time ...</b>	73
<b>Udhëtimi shqiptar</b> .....	74
<b>Pogradec</b> .....	75
<b>Gurët e Vezuvit</b> .....	76
<b>Napoli</b> .....	77
<b>Ah, Prishtinë e zhurmshme, Prishtinë ...</b>	78
<b>Protiselau</b> .....	79
<b>Duke u larguar nga Elada aq e vjetër</b> .....	81
<b>Posta e Athinës (publike)</b> .....	83
<b>Kënga e njeriut të sotëm</b> .....	85
<b>Paqja ku duket</b> .....	86
<b>Një ditë padrejtësie që quhet vetëm 25 shkurt</b>	87
<b>Hoteli «Bozhur»</b> .....	88
<b>Jetëgrabitësit</b> .....	89
<b>Faqe fjalori shqip, i grisur nga milicët</b> .....	91
<b>Vrasje ende të pidentifikuara</b> .....	92
<b>Shokët</b> .....	94
<b>Ndarja</b> .....	95
<b>Korça, Korça</b> .....	96
<b>Natyrë e qetë</b> .....	97
<b>Poemë: Erë borziloku ose këngë e fundit për atë që më tregoi përrallën e parë. ...</b>	98



Natasha Lako u lind në Korçë më 13 maj 1948. Ka mbaruar degën e gazetarisë në fakultetin e shkencave politiko-shoqërore, Tiranë. Është bërë e njohur me lexuesin që me botimet e para në moshën 16 vjeçare.

Ka punuar si arsimtare, gazetare, skenariste filmi dhe pranë Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Sot është krimtare në profesion të lirë.

Ka botuar në poezi «Marsi brënda nesh» (1971) «E para fjalë e botës» (1978) «Këmisha e pranverës» (Prishtinë, 1982), «Yllësia e fjalëve» (çmimi «Migjeni» 1986).

Ka botuar në prozë romanin «Stinët e jetës» (1976). Është autore e më shumë se dhjetë skenarëve me subjekte origjinalë në filmat «Mësonjëtorja» (1978), «Një emër mes njerëzve», «Plumba perandorit», «I paharruari» (1990) «Fjalë pa fund», «Muri i gjallë», «Fletë të bardha» etj.

Poezi të saj janë botuar në frëngjisht, gjermanisht, holandisht, italisht, greqisht etj. duke u përfshirë gjithashtu në antologji të poezisë shqipe, të poezisë evropiane dhe antologji botërore të poetëve gra.

Merret gjithashtu me publicistikë dhe shënime kritike.